REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

S T U D I M

MBI

VEPREN PENALE TE SHKELJES SE RREGULLAVE TE QARKULLIMIT RRUGOR (NENI 290) NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

2004-2008

Punoi: Edlira JORGAQI
Shtator 2009

Trendi kohor

Cdo ditë në Shqipëri rregjistrohen afërsisht 2,3 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", e cila provokon vdekjen e afërsisht 0,6 personave në ditë dhe plagosjen e 1,2 personave në ditë.

Për Veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" për vitin 2008

Ka rritje të lehtë të numrit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale prej 0.1 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.
Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale ne vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 12.8 për qind.
Të pandehur të regjistruar, rritje me 11.8 për qind dhe ulje të të pandehurve për të cilet është ngritur akuzë në gjykatë, me 11.7 për qind në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale ne vitin 2007 ishte 26.96 dhe në vitin 2008 është 26.84 për 100.000 banorë.

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2007 ishte 37.3 për qind dhe për vitin 2008 është 36.2 për qind.

Dinamika e kësaj vepre penale (ceshtje te rregjistruara) në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Vihet re se në vitin 2005 ka ulje të procedimeve penale të rregjistruara për këtë vepër penale me 3.2 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka rritje 9.5 për qind të procedimeve penale të rregjistruara në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje me 34.7 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale dhe në vitin 2008 ka rritje të lehte me 0.1 për qind të procedimeve penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor".

Në lidhje me këtë veprër penale, nga të dhënat statistikore të organit të prokurorisë, rezulton një kurbë në rritje deri në vitin 2007 dhe një rënie e lehtë në vitin 2008 për treguesin e cështjeve për të cilat është vendosur mosfillimi nga ana e organit të prokurorisë.
Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë në lidhje me këtë të dhënë gjatë viteve 2004-2008:



Sikurse vihet re edhe nga grafiku i mësipërm, në vitin 2007 rezulton të jetë edhe viti i cili ka rregjistruar edhe vitin me më shumë cështje për të cilat është vendosur mosfillimi nga ana e organit të prokurorisë.

Kështu, në vitin 2005 rezulton një rritje prej 45,6 për qind në krahasim me vitin 2004, në vitin 2006 rezulton një rritje prej 16,1 për qind në krahasim me vitin 2005, në vitin 2007 përsëri rritje prej 6,3 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 një rënie prej 5,9 për qind në krahasim me vitin 2007.

Pavarësisht se në vitin 2008 ky tregues ka ardhur në rënie është detyrë ë organit të prokurorisë për të verifikuar nëse vendimet i mosfillimit janë marrë në përputhje me ligjin dhe me atë c'ka ka të parashikuar Kodi i Procedurës Penale.

Në lidhje me pushimin e cështjeve për këtë vepër penale:

Rezulton nga të dhënat statiskore se:

në vitin në vitin 2005 ka një rënie prej prej 7.7 për qind në krahasim me vitin 2004, në vitin 2006 rezulton një rritje prej 19.6 për qind në krahasim me vitin 2005, në vitin 2007 përsëri rritje prej 36.33 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 një rënie prej 21.3 për qind në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Ceshtje të dërguara gjyqit:

në vitin 2005 rezulton një rritje prej 2 për qind në krahasim me vitin 2004, në vitin 2006 rezulton një rënie prej 5.4 për qind në krahasim me vitin 2005, në vitin 2007 përsëri rritje prej 42 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 një rritje prej prej 12.9 për qind në krahasim me vitin 2007.

Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Rezulton se:
në vitin 2004, janë dërguar në gjyq 43 për qind e ceshtjeve te rregjistruara;
në vitin 2005, janë dërguar në gjyq 45.3 për qind e ceshtjeve të rregjistruara;
në vitin 2006, janë dërguar në gjyq 39.1 për qind e cështjeve të rregjistruara;
në vitin 2007, janë dërguar në gjyq 41.3 për qind e cështjeve të rregjistruara;
në vitin 2008 është ngritur akuzë në gjykatë për 46.5 për qind të cështjeve të rregjistruara në organin e prokurorisë.

Parë në drejtim të periudhave të cilat mund të konsiderohen si periudha problematike në lidhje me këtë vepër penale nga të dhënat statistikore në organin e prokurorisë rezulton se më shumë procedime në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", rregjistrohen ne tremujorin e trete te vitit, pra në periudhën korrik-shtator. Kjo e dhënë rezulton të jetë e tille për të gjithë vitet e marra në studim (2004-2009)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e cështjeve të rregjistruara për këtë vepër penale sipas periudhave 3 - mujore në organin e prokurorisë për periudhën 2004-2009. Theksojmë se për vitin 2009 mungon tre mujori i fundit për shkak të periudhës se kur po përgatitet ky studim.

Sikurse vihet re edhe nga grafiku, rezulton se tre mujori i tretë (korrik-shtator) është koha në të cilën rregjistrohen më shumë procedime penale përsa i takon veprës penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor". I ndjekur më pas nga tremujori i katërt, tremujori i tretë dhe tremujori i parë[1].

[1] tremujori i parë përfshin periudhën janar-mars;
tremujori i dytë përfshin periudhën prill – qershor;
tremujori i tretë përfshin periudhën korrik - shtator
tremujori i katërt përfshin periudhën tetor – dhjetor



<u>Shtrirja gjeografike</u> për këtë vepër penale për vitin 2008, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Përllogaritja për cdo rreth është bërë në përqindje përkundrejt totalit të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në shkallë republike. Sikurse vihet re edhe nga grafiku rrethet tek të cilat vihet re një numër më i madh procedimesh të rregjistruara për këtë vepër penale janë rrethet Tiranë, Durrës dhe Elbasan me përqindjet sipas grafikut të mëposhtëm. Të ndjekur nga rrethet Kavajë, Shkodër, Fier, Lushnje dhe Lezhë.

Neni 290 "Shkelja e rregullave te qarkullimit rrugor"



Pasojat që kanë ardhur nga kjo vepër penale, për vitin 2008, rezultojnë si më poshtë:

Viktima, të mitur 25 dhe madhorë 315 rezultojne për vitin 2008.
Vdekje, **219;**
Plagosje e rëndë, **151;**
Plagosje e lehtë, **305**.

Grafikisht, të dhënat në lidhje me pasojat për vitet 2004-2008 jepen në grafikun e mëposhtëm. Sikurse vihet re, pasoja "plagosje e lehtë" rezulton të jetë më e shpeshtë në rastet e verifikuara nga kjo vepër penale e ndjekur më pas nga "vdekja" dhe së fundi "plagosja e rëndë"[2].



Në lidhje me pasojën "vdekje"nga vepra penale "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", nga të dhënat statistikore të organit të prokurorisë rezulton se në vitin 2005 ka një rritje të të vdekurve si rrjedhojë e kësaj vepre penale prej 8 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 38 për qind të kësaj pasoje në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një

[2] per vitin 2004, ne te dhenat statistikore te sistemit te prokurorise nuk ka ekzistuar ndarja "plagosje e lehte" dhe "plagosje e rende". Te dhenat rezultojne te jene thejsht"plagosje" duke i perfshire te dyja rastet.

rritje shumë të ndjeshme prej 94,1 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 vihet re nje rënie e lehte e veprës penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor" me pasojë vdekjen prej 4,4 për qind në krahasim me vitin 2007.
Sa më sipër paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Vdekshmëria në aksidentet automobilistike është një tregues tjetër mjaft i rëndësishëm dhe që duhet të merret në konsideratë për t'u trajtuar parë edhe në krahasim me vende të tjera evropiane. Kështu, rezulton se treguesi i vdekshmërisë nga aksidentet automobilistike në vitin 2005 është rritur me 11.5 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 43 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ky tregues është rritur me 44 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rënie prej 4,5 për qind në krahasim me vitin 2007.

Grafik- treguesi i vdekshmërise



Në lidhje me këtë tregues, parë në një këndvështrim krahasues me vende të tjera si për shembull Italia, theksojmë se të dhënat që vijnë në lidhje me këtë tregues janë mjaft alarmante. Kështu, treguesi i vdekshmërise për Italinë dhe Shqipërinë për të njëjtat periudha janë si më poshtë:

Vitet	Treguesi i vdekshmërisë ne %		Pesha specifike e vdekshmërisë ne %	
	Shqipëria	Italia	Shqipëria	Italia
2004	29,4	2,5	42.5	1,8
2005	32,8	2,4	62.2	1,7
2006	18,7	2,4	54.9	1,7
2007	26,9	2,2	61.2	1,6
2008	25,7		59.2	

Grafik- Treguesi i vdekshmerise dhe pesha specifike e saj-Vitet 2004-2008



Në lidhje me plagosjet rrjedhoje e aksidenteve automobilistike, theksojmë se vihet re një kurbë me ulje dhe ngritje të theksuara. Kështu, në vitin 2005 rezulton një rritje e ndjeshme prej 54.4 për qind e pasojës plagosje (përfshirë plagosje e lehtë dhe plagosje e rëndë) në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 vihet re një rënie e lehtë prej 29,2 për qind në krahasim me vitin 2005 për këtë tregues; viti 2007 ka një rritje të theksuar prej afërsisht 80 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe viti 2008 ka një rënie fare të lehtë prej 4.3 për qind në krahasim me vitin 2007.



Të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni **290 i Kodit Penal** "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" janë gjithsej 570. Nga këta, 19 janë të mitur dhe 551 të rritur. Theksojmë se numri i të pandehurve femra/madhore ka ardhur duke u ulur nga 22 të rregjistruara për vitin 2007 në 16 vitin 2008, ose me një ulje prej 27.3 për qind.

Procedime sipas rretheve
(2004-2008)





Në lidhje me pafajësitë me vendim gjykate, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2005 ka një ulje prej 20 për qind në krahasim më vitin 2004; në vitin 2006 ka një ulje prej 25 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje prej 167 për qind të pafajësive të dhëna me vendim gjykate në krahasim me vitin 2006 dhe ne vitin 2008 jemi në të njëjtat shifra sikurse dhe viti 2007, pra 8 të tilla.

NENI 291
"DREJTIMI I AUTOMJETEVE NE GJENDJE TE DEHUR APO PA DESHMI".



Edhe në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa deshmi" vihet re një tendencë në rritje e procedimeve të rregjistruara pranë organit të prokurorisë. Kështu, sipas të dhënave statistikore vihet re një rritje e procedimeve në vitin 2005 prej 2.4 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 23 për qind në krahasim me vitin 2005; ne vitin 2007 ka përsëri nje rritje të ndjeshme prej 84,2 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka përsëri një rritje prej 23,4 për qind të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale, në krahasim me vitin 2007.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e kësaj vepre penale në vitet 2004-2008 në lidhje me cështjet e rregjistruara dhe në lidhje me ato cështje për të cilat është ngritur akuzë në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë.



Sikurse vihet re edhe në grafik, nga viti në vit ka një tenndencë në rritje si të **procedimeve të rregjistruara** për këtë vepër penale ashtu edhe për ngritjen e akuzës në gjykatë nga ana e prokurorisë. Kështu, në vitin 2005 ka rritje prej 2,4 për qind të ceshtjeve të rregjistruara në kraahsim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje të ndjeshme prej 23 për qind te ceshtjeve të rregjistruara në krahasim me vitin 2005; përsëeri rritje të ndjeshme ka në vitin 2007 prej 84 për qind në krahasim me vitin 2006 dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 23,4 për qind në krahasim me vitin 2007 të procedimeve të rregjistruara për këtë vepër penale në organin e prokurorisë.

Me tendencë në rritje të vazhdueshme nga viti në vit paraqitet edhe treguesi i ngritjes së akuzës në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë. Kështu, nga të dhënat statistikore rezulton se:

Ne vitin 2005 ka një rritje prej 3,9 për qind në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 25 për qind në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka një rritje prej 77 për qind në krahasim me vitin 2005; dhe në vitin 2008 ka një rritje prej 40.4 për qind në krahasim me vitin 2005, të ngritjes së akuzës në gjykatë nga ana e organit të prokurorisë.

Grafik- procedime të rregjistruara sipas tremujorëve- neni 291.



Sikurse vihet re edhe nga grafiku, peruiudha në të cilën rregjistrohen më shumë procedime penale për këtë vepër penale është tremujori i tretë (korrik-gusht-shtator) dhe tremujori i katërt (tetor-nentor-dhjetor). Karakteristik është viti 2008, vit në të cilin në tremujorin e dytë janë rregjistruar më shume vepra penale sesa në tremujorin e tretë dhe të katërt, janë rregjistruar 77 procedime penale për këtë vepër penale.


Neni 291
"Drejtimi i automjeteve ne gjendje te dehur apo pa deshmi"
300
250
200
150
100
50
0
2004
2005
2006
2007
2008
85
69
69
86
87
81
107
98
101
179
125
124
250
240
237
te pandehur
te denuar Kërkimi i Prokurorit
te denuar Vendim Gjykate.


Neni 291
"Drejtimi automjeteve ne gjendje te dehur apo pa deshmi
60
50
40
30
20
10
0
2004
2005
2006
2007
2008
1
1
6
1
35
2
42
4
51
1
Vdekje
plagosje



Nga pikëpamja e legjislacionit në fushën konkrete.

Theksojmë se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka të parashikuar shprehimisht nenin 290 "Shkelja e rregukllave të qarkullimit rrugor" dhe neni 291 "Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi", përkatësisht si më poshtë:

"Neni 290
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.
Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Neni 291
Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi

Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara ne gjendje të dehur apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj".

Kodi Penal është miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 dhe ka pësuar ndryshime të herëpasherëshme si më poshtë:
Ligji nr. 8733, datë 24.01.2001;
Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003;
Ligji nr. 9275, datë 16.09.2004;
Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 dhe
Ligji nr. 10023, datë 27.11.2008.

Në të gjitha ndërhyrjet që janë bërë në Kodin Penal në vite këto dy dispozita asnjëherë nuk janë prekur nga ana e legjislativit shqiptar.
Për arsyen e shifrave alarmante që kanë dalë nga ky studim mendoj se duhet të ndërmerret domosdoshmërisht nisma ligjore për rishikimin e këtyre dispozitave.
Parë në një këndvështrim krahasues, vemë në dukje faktin se mjaft shtete të tjera nuk e kanë të trajtuar si vepër penale në mënyrën se si është trajtuar dhe konceptuar në Kodin tonë Penal.
Nga pikëpamja formale, në Kodin Penal italian, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nuk është trajtuar si vepër penale kundër rendit dhe sigurisë publike, por si vepër penale në titullin kundër personit, në kreun e krimeve kundër jetës dhe sigurisë personale. Në këtë kod, janë përkatësisht nenet 589 dhe 590 të cilët parashikojnë shprehimisht se:

Neni 589
Vrasja me dashje

Kushdo qe shkakton me faj vdekjen e nje personi denohet me burgim nga 6 muaj deri ne 5 vjet.
Nese vepra penale eshte kryer ne shkelje te normave mbi disiplinen ne qarkullimin rrugor apo per parandalimin e fatkeqesive ne pune denimi eshte me burgim nga 1 deri ne 5 vjet.
Ne rast te vdekjes se disa personave, ose vdekja e nje personi dhe demtimi i nje ose disa personave te tjere, zbatohet denimi qe duhej te jepej per shkeljen me te rende te rritur deri ne tre fish, por jo me shume se 12 vjet.

Neni 590
Dëmtime(plagosje) personale me dashje

Kushdo qe i shkakton me faj plagosjene dikujt tjetër denohet me burgim deri ne 3 muaj ose me gjobe deri ne 600000 lira.
Nese plagosja eshte e rende denohet me burgim nga 1 deri ne 6 muaj ose me gjobe 240.000-1.200.000 lira; nese eshte shume e rende, me burgim nga 3 muaj ne 2 vjet ose me gjobe nga 600.000-2.400.000 lira.
Nese faktet e mesiperme kryhen ne shkelje te normave te qarkullimit rrugor denimi per plagosjet e renda eshte me burgim nga 2 –6 muaj ose me gjobe 480.000 –1.200.000 lira; denimi per plagosjet shume te renda eshte me burgim nga 6 muaj – 2 vjet ose me gjobe 1.200.000-2.400.000 lira.

Ne rast te demtimit te disa personave zbatohet denimi me i rende per veprat qe akuzohet, rritur ne trefish, por denimi me burgim nuk duhet te kaloje 5 vitet".

Po kështu përmendim Kodin Penal të përkohshëm të Kosovës, nenet 297 dhe vijues të tij janë nën të njëjtën frymë sikurse dhe Kodi Penal italian përsa i përket masës së dënimit.

Nga sa më sipër, është evidente se në rastet kur vepra penale nga e cila është shkaktuar vdekja e një përsoni dhe vepra penale është kryer në shkelje të normave në qarkullimin rrugor dënimi është me burgim nga 1 deri në 5 vjet. Në vitin 2002 minimumi i këtij dënimi është rritur nga 1 vit heqje lirie në dy vite heqje lirie, kohë në të cilën në Kodin tonë Penal parashikohet (neni 290) dënimi me gjobë ose me burgim gjer ne 10 vjet.
Mendoj se ky marzh kaq i hapur dënimi për këtë vepër penale me pasojë vdekjen duhet detyrimisht të ndryshojë drejt forcimit të politikave penale të dënimit për këto raste. Mendoj se për raste të tilla parashikimet e Kodit Penal duhet të jenë të jenë të tilla që të mos i lenë mundësi agjencive të zbatimit të ligjit të abuzojnë me të, e aq më tepër me të drejtën për të jetuar, e cila duhet konceptuar si një e drejtë absolutisht e pacënueshme, për të cilën as vetë Kushtetuta nuk e ka mundësinë e lejimit të kufizimit të saj.

Jeta e personit mbrohet me ligj. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. E drejta për jetën paraqitet në Kushtetutë, si një vlerë, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera. Parimet themelore të mbrojtjes së jetës gjejnë mbështetje të plotë në këto dispozita. Jeta është një e drejtë, atribut fondamental i qënies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret në cfarëdolloj mënyre, njeriu në të njëjtën kohë eleminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas nenit 15 të Kushtetutës, janë të pandashme, te patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojne në themel të të gjithë rendit juridik, prandaj ekziston edhe detyrimi parësor dhe kushtetues i shtetit, nëpërmjet organeve të tij, që t'i respektojë dhe t'i mbrojë këto të drejta.

Vlera më superiore për shtetin dhe shoqërinë është njeriu dhe jeta e tij, e cila qëndron në themel të të gjitha të drejtave. Jeta njerëzore, duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Por problemi që shtrohet për t'u zgjidhur është se sa është në

gjëndje të bëjë një shtet ose një shoqëri e tërë për jetën njerëzore në mënyrë që të mbrojë dhe të garantojë një nivel të caktuar jetese? Dihet se për arsye të shumta shumë nga ne mund të jenë ndjerë të pasigurtë për jetën e tyre. Dhe kjo ka shpjegimet e veta.